



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:257223

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05677652

C.nr.4230/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.Gj. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T. së Kosovës në Prishtinë të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, me objekt të kontestit kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 616.47 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **30.04.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET tërësisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.Gj. nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Arsimit dhe shkencës, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri më datë 30.04.2022 apo për vitin 2019 - 12 muaj (për çdo muaj shumën prej 13.64 euro, në shkallë prej 2.7% të pagës bazë- 505.32 euro, për vitin 2020 - 12 muaj (për çdo muaj shumën prej 1.01 euro, në shkallë prej 0.2% të pagës bazë- 505.32 euro, për vitin 2021 - 12 muaj (për çdo muaj shumën prej 17.18 euro, në shkallë prej 3.4% të pagës bazë- 505.32 euro, për vitin 2022 - 4 muaj (për çdo muaj shumën prej 58.61 euro, në shkallë prej 11.6% të pagës bazë- 505.32 euro në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 616.47 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 13.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja M.Gj. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës M.A.Sh.T. së Kosovës në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i inflacionit në pagë, vlera e kontestit 616.47 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se është e punësuar si mësimdhënëse pranë Shkollës Qendra Burimore “Zef Nosi” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion dhe është e licencuar si mësimdhënëse. Tutje, ka theksuar se paditësja në bazë të listës së pagave realizon pagë bazë prej 505.32 euro, ndërsa shtesën për vitin 2019 mesatarja e inflacionit në ven ka qenë 2.7% ,per vitin 2020 mesatarja e inflacionit në ven ka qenë 0.2%, për vitin 2021 mesatarja e inflacionit në ven ka qenë 3.4% , për vitin 2022 mesatarja e inflacionit në ven ka qenë 11.6% të kësaj page, respektivisht e paditura ia paguan shumën prej 616.47 euro.

E paditura Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në Prishtinë, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 22.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Tutje ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura duke u bazuar në vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura. Mirëpo Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës në Prishtinë, në buxhetin e vitit 2021 nuk ka pas buxhet për kompensimin e kësaj pagese, bazuar në nenin 46 të Kontratës Kolektive Nr.01B/2056 e datës 18.04.2017, si dhe ka theksuar asnjë provë sa i përket inflacionit në pagë. Po ashtu kanë theksuar se bazuar në nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës(Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës) në Prishtinë, viti v/ Nr.30/01 dhjetor 2010) “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri vjet”. Si dhe në bazë të nenit 341 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është arritur parashkrimi në këtë çështje “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Bazuar edhe në nenin 47 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B/105 e datës 22.01.2021 Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056 e datës 18.04.2017 është shfuqizuar dhe nuk është në fuqi. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja M.Gj. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë Shkollës Qendra Burimore “Zef Nosi” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata me numër të protokollit nr. 311043/133 të datës 02.03.2016 vërtetoi faktin se paditësja është e punësuar në Shkollën Qendra Burimore “Zef Nosi” në Prizren që nga viti 2015, dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie kontraktuale. Kontratë kjo e lëshuar nga drejtori i shkollës si dëshmi për të vërtetuar marrëdhënien që ka me shkollën paditësja.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 505.32 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit universitar, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 60.11 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 08.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2023:257223
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05677652

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.4230/23, të datës 30.04.2024

**Gjyqta
rja
Edije Sezairi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.